



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS SË JASHTËZAKONSHME PLENARE TË KUVENDIT TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 5 MARS 2026, ora 20.00**

**SA VANREDNE PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 5. MARTA 2026. GODINE, 20.00 časova**

MARS - MART
2026

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i Propozim-amendamenteve Kushtetuese të propozuara nga Presidentja e Republikës së Kosovës.

Dnevni red

1. Razmatranje predloga ustavnih amandmana koje je predložila predsednica Republike Kosovo.

Seancën e drejtoi kryetarja e Kuvendit, znj. Albulena Haxhiu.

KRYETARJA: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe,

Ministra të Kabinetit qeveritar,

Të nderuara media,

Të nderuar të pranishëm,

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e thirrur me kërkesë të 41 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Vazhdojmë me pikën e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve kushtetuese, të propozuara nga Presidentja e Republikës së Kosovës

Komisioni për Legjislacion i ka shqyrtuar amendamentet kushtetuese numër 27, 28, 29 dhe 30, që kanë të bëjnë me zgjedhjen e drejtpërdrejtë të presidentit apo presidentes nga populli. Komisioni i përkrahu amendamentet e propozuara për amendamentimin e Kushtetutës, pra ato numër 27, 28, 29 dhe 30, të vlerësuara me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, KO212 dhe KO4812.

Me këtë rast ftoj kryetarin e Komisionit për Legjislacion, zotin Përparim Gruda, që para deputetëve të Kuvendit të arsyetojë raportin me rekomandime.

PËRPARIM GRUDA: Kryetare, në Komisionin për Legjislacion janë shqyrtuar amendamentet dhe me shumicë votash i janë përcjellë seancës plenare. Pjesën tjetër të diskutimit tim do ta koncentroj si diskutimin si deputet. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Gruda!

Tani po vazhdojmë me shefat e grupeve parlamentare. Nga Lëvizja Vetëvendosje, zonja Nagavci.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, e nderuar kryetare e Kuvendit!

I nderuar kryeministër Kurti,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të gjithë ju të pranishëm,

Të dashur qytetarë,

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje mbështet amendamentet kushtetuese të propozuara nga Presidentja e Republikës së Kosovës, zonja Vjosa Osmani-Sadriu, amendamente këto që synojnë që presidenti apo presidentja e vendit të zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët.

Siç e dimë të gjithë, përvoja na e ka dëshmuar se procesi i zgjedhjes së presidentit në Kuvend shpeshherë është shoqëruar me marrëveshje joparimore politike ose kemi pasur edhe situata të bllokimit institucional. Në këtë linjë zgjedhja e presidentit në një republikë demokratike mund të bëhet ashtu siç e dimë në dy forma: përmes votës së drejtpërdrejtë të qytetarëve ose përmes përfaqësuesve të tyre në Kuvend.

Debati, i cili adreson edhe synimin e këtyre amendamenteve për mënyrën e zgjedhjes së presidentit në Kosovë nuk është një debat i ri. Është diskutuar për më shumë se një dekadë dhe është pjesë e një reflektimi të gjatë institucional. Kur presidenti zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët, ai apo ajo ka mandat të qartë nga populli.

Pra, ndryshe nga rregullimi aktual juridik te ne, kur vendimi varet nga marrëveshjet në mes të partive politike, nëse do të votohej drejtpërdrejt nga qytetarët, presidenti do të kishte mbështetje më të drejtpërdrejtë nga populli, pra edhe legjitimitet më të madh demokratik. Kur qytetarët votojnë për presidentin, ata ndihen më të përfshirë në procesin politik dhe kjo rrit edhe interesimin për demokracinë dhe për zgjedhjet në përgjithësi. Për më shumë, një president i zgjedhur nga qytetarët duhet të fitojë votën e shumicës së qytetarëve dhe grupeve të ndryshme të shoqërisë, e jo vetëm të deputetëve dhe kjo mund të bëjë që një figurë të jetë më përbashkuese për qytetarët dhe për vendin.

Andaj si Grup Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, siç e ceka, japim mbështetjen për këto amendamente dhe po ashtu i ftojmë të gjithë deputetët që të mbështesin këtë iniciativë në mënyrë që të avancojmë më tej demokracinë dhe stabilitetin institucional në vend. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zonja Nagavci! Tani nga PDK-ja është deputeti Bedri Hamza.

BEDRI HAMZA: E nderuar kryetare e Kuvendit!

I nderuari zoti kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra,

Të nderuar deputetë.

Partia Demokratike e Kosovës vlerëson se çështja e zgjedhjes së presidentit nga populli është një temë shumë e rëndësishme kushtetuese, është një temë që meriton trajtim serioz institucional dhe politik. Po, a është ky trajtim serioz? Unë e them aspak. Qysh t'i thuhet 'trajtim serioz' në këtë

rast, kur edhe propozuesja e këtyre amendamenteve në orët e fundit të mandatit të saj i gjen disa amendamente të trajtuara përpara 15 vjetëve.

Më vjen keq, zonja kryetare e Kuvendit që dhe Kuvendi po hyn në këtë valle të trajtimit të aktit më të lartë juridik të vendit, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, amendamentimit të Kushtetutës në një mënyrë joserioze. Seanca thirret për një çështje kaq të rëndësishme në 19:45 dhe materialet deputetëve u vijnë në orën 20:30.

Si munden deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës për një temë kaq të rëndësishme, për aktin më të lartë juridik të vendit të flasin pa i pranuar dokumentet.

Në parim, Partia Demokratike e Kosovës ka qenë, është edhe sot, do të jetë edhe në të ardhmen që presidenti të zgjidhet direkt nga populli, nga qytetarët. Mirëpo, kjo do një trajtim serioz dhe kjo domosdoshmëri duhet të jetë e vendosur brenda kuadrit ligjor, brenda Kushtetutës së Republikës së Kosovës, brenda procedurave, brenda rregullave që kërkojnë të trajtohet kjo çështje.

Nuk është respektuar Rregullorja e Punës së Kuvendit, nuk është në përputhje me ato çka ka thënë Gjykata Kushtetuese lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së amendamenteve të propozuara. Prandaj, ne konsiderojmë që kjo do një diskutim më të gjerë, një konsensus më të gjerë politik, edhe mes subjekteve politike, edhe gjithë të tjerëve që në të ardhmen të startojë në mënyrë të rregullt diskutimi për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe posaçërisht për zgjedhjen e presidentit apo presidentes të Republikës së Kosovës drejtpërdrejt me votën e qytetarëve.

Prandaj, në këtë mënyrë ne nuk mund të flasim në mënyrë meritore sonte. Kjo, sonte unë kam pritur që, jo sonte, në fakt, shumë më herët që Kosova ta ketë zgjedhur presidenten apo presidentin dhe jo të vijmë në këtë situatë, kur në orët e fundit të mandatit deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës të sfidohen me një seancë të jashtëzakonshme, pa material dhe të flasim për plotësim-ndryshimin apo amendamentimin e aktit më të lartë juridik të vendit Kushtetutës Republikës së Kosovës. Në parim jemi për, po kjo kërkon një trajtim, përputhje me rregulloret, me ligjin edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit!

Kuvendi e ka për obligim që t'i trajtojë amendamentet kushtetuese. Nuk ka pasur asnjë shkelje, sapo janë proceduar nga Presidentja Osmani, janë trajtuar nga Komisioni për Legjislacion, janë votuar me gjashtë vota për në Komisionin për Legjislacion, dy kanë qenë kundër dhe pastaj e kemi proceduar, domethënë kjo seancë është proceduar me nënshkrimet e deputetëve.

Sipas Kushtetutës, deputetët mund ta thërrasin seancën e jashtëzakonshme, prandaj nuk ka asnjë shkelje në këtë drejtim. Zoti Hamza, do ta keni mundësinë sërish, sepse jemi te radha e grupeve parlamentare. Në rregull, Zoti Hamza, vazhdoni!

BEDRI HAMZA: Faleminderit, zonja kryetare!

Zonja kryetare, veç ta konstatojmë një fakt që seanca është thirrur për në orën 20:00, është ftuar në 19:45 minuta. Materialet deputetët i kanë marrë në orën 20:30 minuta, kjo është. Unë mendoj që materialet duhet t'i paraprijnë fillimit të seancës dhe t'u shpërndahen deputetëve para orës kur duhet të fillojë seanca, jo të vijnë gjysmë ore mbasi që të ftohet seanca dhe për 15 minuta. Është mirë që të gjithë këta deputetë janë në sallë, po për 15 minuta është vështirë të sillen deputetët në sallën e Kuvendit të Kosovës.

KRYETARJA: Megjithatë janë katër amendamente. Në e-mail e keni raportin me amendamente, ju ftoj që t'i lexoni. Jemi në rrethana të tilla të jashtëzakonshme, prandaj edhe duhet të veprojmë në përputhje me rrethanat. Nga LDK-ja? Kush e dëshiron fjalën? Zoti Abdixhiku!

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, zonja kryetare!

Tani të dashur qytetarë të Republikës, për të qenë shumë të qartë, LDK-ja i mbështet në parim amendamentet e tilla, sepse janë në frymë me bindjen tonë ideologjike.

Presidenti i Kosovës duhet të zgjidhet nga qytetarët drejtpërsëdrejti.

Po, më lejoni të shtroj sepse kjo çështje tona na takon neve si Kuvend këtu, pavarësisht të gjitha vërejtjeve me të cilat pajtohem. Kushtetuta ndërrohet natën, besoni s'ka bereqet. S'di, tani më lejoni, ju lutem, do ta keni kohën, më lejoni, e dhashë mbështetjen.

Ta përsëris edhe një herë: LDK i mbështet dhe i voton. Po, dëgjoni, kujdes, ju lutem, mos u ngutni, ato fjalimet që i keni shkruar, rishkruani edhe një herë, që ua kanë shkruar. Më lejoni, ju lutem, dy çështje shumë e rëndësi që të kemi parasysh. E para, këto amendamente kushtetuese janë hartuar edhe nga Lidhja Demokratike e Kosovës vitin 2011. Me një proces, shikoni, e kuptoj që keni provuar, e provoni që LDK-në ta vendosni në një pozitë të palakmueshme, nuk do ta arrini. Më lejoni, tani ta shfaq qëndrimin e LDK-së.

Pra, në vitin 2011 këto amendamente janë dërguar në Gjykatë Kushtetuese nga Lidhja Demokratike e Kosovës, nga ne, ne i kemi dërguar, sepse që ta kuptoni janë bindje ideologjike që datojnë nga Presidenti historik, doktor Ibrahim Rugova. Pra, presidenti duhet të zgjidhet nga populli. Tani ky koncept kërkon një rregullim të ri kushtetues, do të duhej më tepër punë, po ja ku jemi në gjendje të tillë, le të themi se po i kapërcejmë këto. Çështja bazike është se prej 2012 kur Gjykata Kushtetuese ka marrë, ka dhënë filtër, ka dhënë pëlqim dhe amendamentet që keni para vete, në qoftë se i keni lexuar janë të pastruara prej komenteve të Gjykatës Kushtetuese.

Ky Kuvend i Republikës s'ka arritur asnjëherë t'i kalojë ato, për një fakt shumë të thjeshtë, mungesës së vullnetit tek shumica e dyfishtë. Pra, përveç që duhen 2/3 e shqiptarëve, duhen 2/3 dhe të joshqiptarëve, pra pakicave, minoriteteve.

Dhe çështja e dytë që duhet ta kuptoni në ato amendamente, të cilat i keni para vetes, aty thotë qartë se këto amendamente hyjnë në fuqi gjashtë muaj pasi të votohen nga Kuvendi i Kosovës. E, ne jemi nja dy-tre orë larg afatit përfundimtar.

Pra, edhe po t'i kalojmë e duket që s'i kemi pakica këtu s'i kemi pasur për 14 vjet, sepse, mos harroni, kërkesat e tyre kanë qenë shumë më të thella, kanë qenë për zëvendëspresident serb, prandaj s'kemi arritur asnjëherë të bëjmë kompromis. Po edhe sikur të kalonte një gjë e tillë, këto amendamente hyjnë në fuqi gjashtë muaj nga sot. E ne jemi dy-tri orë larg para dekretit potencial për zgjedhje të reja. Kishte qenë mirë që këtë kohë ta kishim shfrytëzuar më mençur, por këto janë manovra politike të natës. Nata nuk ka bereqet. Prandaj, LDK i mbështet dhe i voton. Ju faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Abdixhiku! Nga Grupi Multietnik është deputeti Erxhan Galushi.

ERXHAN GALUSHI: E nderuar kryetare e Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar përfaqësues të mediave,

Të nderuar qytetarë,

Sonte jemi mbledhur këtu në një seancë të jashtëzakonshme për të trajtuar një çështje jashtëzakonisht të rëndësishme dhe të shumëpritur prej vitesh. Tashmë ka ardhur momenti që të vendosim për një hap të rëndësishëm demokratik, mundësinë që presidenti i vendit të zgjidhet drejtpërdrejt nga populli.

Megjithatë, kjo do të bëhet e realizueshme dhe është e domosdoshme që të sigurohen votat e nevojshme për ndryshimin e amendamenteve kushtetuese të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Si pjesë e Grupit Multietnik, ne do t'i përkrahim këto amendamente dhe me këtë do të dëshmojmë edhe njëherë se komunitetet joshumicë joserbe kanë qenë dhe do të mbesin gjithmonë faktorë të rëndësishëm në zhbllokimin e çdo shtate që paraqet pengesë për funksionimin e plotë të institucioneve tona.

Ne veprojmë gjithmonë në interes të vendit dhe të gjithë qytetarëve të saj pa dallim. Ju faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, i nderuar deputet! A ka deputetë të cilët janë paraqitur për fjalë?
Po e shoh z. Përparim Gruda. Urdhëroni!

PËRPARIM GRUDA: Faleminderit, e nderuar kryetare!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë të Kosovës,

Në çdo shoqëri normale debati për ndryshimet kushtetuese është debati më i gjerë mbi normat e një vendi. Nuk i përfshin veç partitë politike, nuk i përfshin veç deputetët, e përfshin krejt shoqërinë. Edhe për ta miratuar një udhëzim administrativ duhen dy javë konsultim publik.

Neve këtu na është sjellë teksti i amendamenteve, i cili është i shkruar para 14 vjetësh dhe ka kaluar në Gjykatë Kushtetuese fiks para 14 vjetësh. Prej atëherë, Kushtetutës së Kosovës i janë bërë 26 amendamente dhe normalisht me interpretimet që i janë bërë asaj prej Gjykatës Kushtetuese, ka ndërruar, jurisprudenca e saj ka ndërruar plot botëkuptime që kemi pasur ne mbi Kushtetutën.

Prandaj, përdorimi sot i një vlerësimi kushtetues që e ka bërë Gjykata Kushtetuese para 14 vjetësh është i paprecedent. Është i paprecedent! Nuk ka vend tjetër evropian, unë e sfidoj çdokënd prej kabinetit qeveritar, prej juristëve që na këqyrin, nëse gjejnë një vend në të cilin kontrolli paraprak i amendamenteve kushtetuese siç është në rastin tonë bëhet sot, ndërkaq miratimi thirret të bëhet mbas një dekade e tutje, unë nuk dal të flas më në këtë Kuvend për ligj.

Mbi të gjitha, mbi të gjitha, tash do të dal te çështjet konkrete.

Kryetare, ju lutem, nëse mund të kërkonti qetësi se s'po mund të flas!

KRYETARJA: Ju lutem që të mbani qetësi, sepse deputeti Gruda duhet ta përfundojë fjalë pa pengesë.

PËRPARIM GRUDA: Po dal te çështjet konkrete.

Ky Kuvend funksionon sipas Rregullores së Punës të vet. Kryetare, ky Kuvend funksionon sipas Rregullores së Punës dhe më lejoni t'juja lexoj Rregulloren e Punës çfarë thotë për këtë rast. Thotë: S'e ke lexuar! Dëgjoje tash, se s'e ke lexuar! Tash kur ta lexoj unë, e sheh që s'e ke lexuar. S'e ke lexuar!

“Seanca plenare për të miratuar amendamentet kushtetuese thirret brenda dy javësh nga marrja e vlerësimit nga Gjykata Kushtetuese”.

Dy javë, 14 vjet mbrapa jemi. Dy javë po thotë, shihe! Kryetare, dy javë. Dy javë seanca për miratim. A jemi në seancë për miratim ne? Më fal, a jeni në seancë për miratim? Po thotë: “Seanca për miratimin e amendamentit, siç është kjo, thirret dy javë pasi merret vendimi i Gjykatës Kushtetuese”. Ne jemi 14 vjet mbrapa.

KRYETARJA: Fol me qytetarët, para qytetarëve, jo me mua!

PËRPARIM GRUDA: Jo, unë po flas me juve se ju kujdeseni për Rregulloren në seancë.

KRYETARJA: Drejtoju qytetarëve, jo mua, të lutem!

PËRPARIM GRUDA: Pse jo ty?

Më fal, për këtë Rregullore, kryetare, kujdeseni ju apo jo? Ju jeni autoriteti final i këtij Kuvendi ta interpretoni Rregulloren? A është kështu? Nëse s’është kështu, thuama! Është kështu.

Prandaj, po të drejtohem ty. Si kryetare e Kuvendit, pse lejon ti të shkelet Rregullorja e Kuvendit? Pse e lejoni një gjë, se ti e paske lexuar, po s’e paske lexuar mirë. Po thotë dy javë, jo 14 vjet. Pse lejoni ju pas 14 vjetësh të sillen këto amendamente kushtetuese? Pse? E para.

E dyta, pyetja që bëhet është: pse kaq shumë urgjencë? Pse ka kaq shumë urgjencë të miratohen sonte amendamentet kushtetuese? Pse ka kaq shumë urgjencë? Sepse s’e lejon Rregullorja. Po më pyet deputetja pse jo? S’e lë Rregullorja, deputete!

Këto amendamente kushtetuese po ashtu janë sjellë në mënyrë të gabuar në këtë Kuvend. Procesi i amendamentimit kushtetues është ky: Presidentja ose një e katërta e deputetëve e bëjnë propozimin, amendamentet çohen në Gjykatë Kushtetuese, hapi i dytë; hapi i tretë sillen në Kuvend, në Komisionin për Legjislacion dhe vijnë këtu për miratim. Neve sot na i ka sjellë Presidentja direkt në Komisionin për Legjislacion. S’ka të drejtë. Ne e marrim Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, jo propozimet e Presidentes. Andaj, bashkë jeni duke e shkelur procedurën themelore të ndryshimit të aktit themelor të një shteti. Është për keqardhje!

Nuk kemi të bëjmë me kurrfarë dije të thelluar as me kurrfarë filozofie. Dy javë janë, sido ta interpretosh, janë dy javë, s’bëhen 14 vjet kurrë.

Prandaj, shikoni, unë e di që krejt po bëhet për fushatën që na pret. Krejt janë këtu. Aty është qëllimi. Unë po flas si jurist. Unë për asnjë vlerësim, edhe kryetari Hamza e shprehu qëndrimin e partisë sonë. Nuk mendoj që në këtë Kuvend, një deputet që e lexon këtë paragraf që thotë dy javë, e jemi pas 14 vjetësh, nuk duhet votuar. Shikoni, kjo është rregulla themelore! Çka mund ne t’u themi njerëzve të tjerë për respektim të rendit e ligjit, kur organi që nxjerr ligjet, që nxjerr

Kushtetutën, e shkel vetë procedurën, jo në ligjet të zakonshme, në ndryshimin edhe miratimin e aktit themelor të shtetit.

Prandaj, mendoj që është për keqardhje!

Tash, kryetare, po dua ta shfrytëzoj minutën të ta bëj një pyetje. A mund të ma shpjegosh pak mua pse këtu thotë dy javë dhe ti pas 14 vjetësh i qet amendamentet? Pyetja imja për juve. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! A ka deputetë të tjerë? Po, znj. Hykmete Bajrami dhe pastaj z. Zemaj.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Jemi vetëm disa orë para se vendi të shkojë prapë në zgjedhje dhe po diskutojmë amendamente kushtetuese, siç u tha me 14 vjet vonesë.

Qytetarë të nderuar,

Të kthehem i te tema kryesore. Sot kjo seancë është thirrur të bëhet shpërqendrim i vëmendjes. Sot, kjo seancë është thirrur nga ata, të cilët para disa javësh i morën 51 për qind të votave, për ta adresuar çështjen e bujqve, të cilët ende nuk i kanë marrë subvencionet e vitit të kaluar, për ta adresuar çështjen e qytetarëve, të cilët i pret një valë e re e inflacionit nga luftërat në botë. E këta dalin u thonë njerëzve që inflacionin e rregullon Mimeoza me një vendim atje për çmimin tavan të naftës dhe e hap ngushticën e Hormuzit.

KRYETARE: Kthehu në temë, deputete, fol për amendamentet!

HYKMETE BAJRAMI: Jam pikërisht aty, kryetare!

Dhe këta sot na sjellin amendamente kushtetuese. Këta sot i ofendojnë të gjithë pacientët, të cilët janë në spitale dhe dergjen pa barnat esenciale. Këta sot janë kundër qytetarëve, të cilët sytë i kanë nga Gjermania dhe u thonë atyre që e ardhmja...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Regjia!

Ju lutem që të flitni për rendin e ditës!

Rregullorja ma jep të drejtën që në momentin kur je jashtë rendit të ditës ta ndërpres fjalën. Ta tërheq vërejtjen dhe pastaj nëse nuk e ke parasysh, ta ndërpres fjalën.

Regjia ia rikthen fjalën deputetes Bajrami, por po të paralajmëroj që në qoftë se flet jashtë rendit të ditës, sërish të ndërpritet fjala dhe nuk e merr më.

HYKMETE BAJRAMI: Në rend të ditës, sa herë flasim për interesat e qytetarëve jemi në rend të ditës dhe sot nuk ka rend të ditës më të rëndësishme që mos t'i çojmë qytetarët në zgjedhje prapë. Dhe kush po i çon në zgjedhje, po i çoni ju, të cilët i keni marrë 51% të votave dhe keni sjellë në rend të ditës amendamente kushtetuese, të cilët assesi nuk e evitojnë çuarjen e vendit në zgjedhje.

A është dashur sot të bisedohet, të ketë një seancë, për t'u ulur e biseduar për ta sjellë një kandidat konsensual, t'i jepet president vendit dhe qytetarëve të vendit. Çka janë këto lojëra që i bëni me qytetarë? Çka janë këto lojëra? Çfarë keni për t'u thënë 51% të qytetarëve që ju kanë votuar, nesër kur duhet shpërndarë Parlamentin dhe për të shkuar prapë në zgjedhje, duke shpenzuar dhjetëra miliona euro?

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Ndërpritja fjalën deputetes!

Tani e ka fjalën deputeti Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetare e Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Amendamentet e vitit 1912. Shikoni, është problem politik, pak për relaks, dorën në zemër, se po e di që jeni të ngarkuar të gjithë edhe në orët e vona të natës, edhe në vendimmarrje sa për t'u hedhur hi syve qytetarëve.

Kësaj përgjegjësie nuk mund t'i ikni, as kryeministri dhe çdonjëri që e ka pasur mundësinë ta zgjedhë presidentin e ri të vendit sipas afateve kushtetuese. Pasi kemi mbërritur në afatet kushtetuese dhe dikujt i është kujtuar, ashtu siç i është kujtuar shpeshherë që të jetë i vonuar në proceset më të rëndësishme historisë së re të Kosovës, edhe këto amendamente tuaja e kanë logjikën e njëjtë.

Sot, kur po flasim për këto amendamente, asnjë anëtar i Gjykatës Kushtetuese që e ka bërë vlerësimin e tyre nuk është në detyrë. Po, asnjë deputet që ka punuar në dy komisionet, ndoshta ka qenë Albulena, s'po më kujtohet, në njërin prej komisioneve, por nuk është as deputet dhe as nuk është në detyrë. Pse po e them këtë? Këtë po e them ashtu siç është logjika e thirrjes së kësaj seance, edhe e mënyrës së dërgimit të këtyre amendamenteve. Edhe të flasim hapur t'u tregojmë qytetarëve të Republikës së Kosovës, a janë bërë në presion politik ndaj presidentes së vendit? A është lojë e juaja sa për të shtyrë edhe këto orët e fundit të afatit kushtetues, apo fshihet diçka

tjetër që të na fusni në një krizë kushtetuese dhe të arsyetoheni, ose më mirë të them, kryetare, mos ma ndal fjalën, t'i mashtroni qytetarët se dikush po tenton t'u bllokojë për ta ushtruar mandatin tuaj kushtetues edhe ligjor në Republikën e Kosovës sipas rezultateve të fundit zgjedhore.

Kjo çka po bëni sot nuk i ndihmon as demokracisë edhe as jetës parlamentare. Edhe këtë e dini shumë mirë. Më së miri e di Albin Kurti që i është kujtuar për t'i sjellë këto amendamente. Më së miri e di ky. E di edhe qëllimin, e di edhe prapavijën, por i di edhe pasojat, se këto kanë pasoja. Nuk janë këto veprime që po i merrni sot pa pasoja. Nuk jam duke e thënë këtë se po më pëlqen si opozitar. Por, po e them që po i dhemb qytetarit, edhe duhet që edhe neve të na preknin në ndërgjegje këto veprime të cilat ju po i bëni dhe jeni shumicë kuvendore.

Dy javë jeni sjellë thujse nuk po ndodh asgjë në Kosovë. Dy javë, tri javë prej mandatimit të Qeverisë jeni sjellë sikur do ta kemi zgjedhjen e Presidentit pa asnjë problem kushtetues. Pse? Për logjikën e një individi, për dëshirën, për vullnetin e tij? Ndoshta, Albini edhe duke lexuar shumë histori, i është kujtuar se si Ahmet Zogu e ka shndërruar republikën parlamentare me ndryshime kushtetuese, e ka kthyer në monarki, edhe është bërë mbret.

Kjo nuk mund të ndodhë. Ndoshta mund të ndodhë këtu me votë, edhe me këtë mënyrë të thirrjes së seancës, por populli i Kosovës dhe qytetari, i cili ka vuajtur shumë për liri, pavarësi, po mbi të gjitha për demokraci, të jeni të bindur se s'do ta lejojë. Nuk do ta lejojë. Ndoshta mund t'ju tolerojë edhe pak, por ta lejojë, nuk do ta lejojë!

Tërhiqni këto amendamente. Mos e bëni përrallë veten dhe Kuvendin e Kosovës. Të mos tregoni diçka, për të cilën edhe ju e dini që është e pamundshme, edhe tendencën për t'i sfiduar ata të cilët e kanë promovuar gjithmonë zgjedhjen e presidentit në mënyrë të drejtpërdrejtë nga populli i Kosovës. E mund të flasim atëherë për sistemin demokratik në vend, qoftë presidencial, parlamentar, gjysmëparlamentar e çfarë të doni.

Kjo tendenca për t'i sfiduar të tjerët se kush është pro zgjedhjes dhe kush është kundër, te Lidhja Demokratike dhe te deputetët, që besoj që e duan këtë vend, edhe kanë punuar gjatë për këtë vend, edhe mendojnë të punojnë, të angazhohen gjatë për këtë vend, aq sa dinë, at sa munden, në interes të qytetarëve, nuk ndodh. Kështu që, e keni gabim. Këtë e ka kuptuar çdokush, e ka kuptuar edhe qytetari, e ka kuptuar edhe ai laiku që e lexon normën kushtetuese, edhe germën kushtetuese, dhe kjo është e papranueshme. Është edhe e patolerueshme.

Andaj, mos i bëni dëm këtij vendi për teke personale, edhe individuale. Lëreni mundësinë që të zhvillohet demokracia. Por, demokracia ka kufizime. Nuk është një fushë ku çfarë dëshiron merr, dhe çfarë nuk do mund ta lësh. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Zemaj!

Amendamentet kushtetuese i ka propozuar presidentja Vjosa Osmani-Sadriu, jo Qeveria, jo kryeministri Kurti, jo Vetëvendosja, jo Albulena Haxhiu. Prandaj, edhe në shkresat e lëndës e keni të shkruar këtë. Faleminderit!

Nuk ka deputetë të tjerë, të cilët janë paraqitur për fjalë. Po e shoh deputetin Vigan Qorolli. Të lutem, deputet!

VIGAN QOROLLI: Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Debati i përhershëm që bëhet për ndryshimet kushtetuese lidhur me zgjedhjen e presidentit drejtpërdrejt nga populli është shëndeti më i mirë i demokracisë sonë, dhe këto 15 vjet më ka rastisur të dëgjoj që çdo herë, secili formacion politik që e ka paraqitur si një prej të arriturave të veta, ose tendencave, të cilat do të mund ta realizonte këtë synim, që ne sot besojmë fuqimisht që është i realizueshëm.

Në këtë tendencë, nëse ka një vjetërsim potencial të këtyre amendamenteve për 15 vjet, kjo gjë në mënyrë absolute nuk qëndron, sepse ne e dimë që në secilin rast, edhe në gjyqësinë tonë kushtetuese, por edhe në jurisprudencën krahasimtare, që çdo analogji e vlefshme u përshtatet edhe rasteve, të cilat vlejné nga e kaluara historike.

Kjo nënkupton, për ilustrim tuajin dhe për ilustrim të qytetarëve të Kosovës, vetëm t’jua përmendi amendamentin 27 të Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që është paraqitur në atë kohë prej njërit prej etërve themelues të SHBA-ve, James Madison, të cilit nga shtatori i vitit 1789 i janë dashur saktësisht 202 vjet e shtatë muaj të aprovohet dhe kjo ka ndodhur tek në maj të vitit 1992.

Dhe, kjo nuk nënkupton që ky debat duhet të shterohet në kuptim të legjitimitetit të plotë të arsyes nëse duhet zgjedhur ne presidentin nga populli, ose nga Parlamenti. Ne po kërkojmë që presidenti të zgjidhet nga populli, sepse kjo është forma më e lartë e demokracisë përfaqësuese. Dhe, duke qenë se ne po flasim për çështje gjithmonë kohore, nuk po flasim për pyetje të cilat lidhen me përmbajtjen. Do të isha shumë i lumtur që të flasim për përmbajtjen e amendamenteve dhe jo për një retorikë, e cila është e paqëndrueshme dhe nuk lidhet me arsye juridike. Do duhej që si shoqëri të kemi konsensus që ta ndërtojmë bashkërisht një situatë kur kalojmë në zgjedhje.

Nëse një herë Gjykata jonë Kushtetuese në vitin 2012 i ka konfirmuar këto amendamente, vlen parimi i përhershëm, që nuk vlen vetëm në drejtësinë penale, por vlen edhe në drejtësinë

kushtetuese dhe në atë administrative, që parimi që quhet latinisht “ne bis in idem”, pra jo dy herë për të njëjtën gjë thuhet në gjuhën shqipe.

Kështu që, në këtë rast, ne kërkojmë që brenda kësaj normative, Gjykata jonë Kushtetuese ka saktësuar që këto amendamente, të cilat janë sot para jush, nuk i pakësojnë të drejtat e njeriut, dhe ky është diskutim i paqenë prej anës së partive opozitare.

Dhe, një detaj për zotin Abdixhiku: në këtë rast, amendamentet nuk hyjnë në fuqi gjashtë muaj pas miratimit, por zgjedhjet e reja mbahen gjashtë muaj pas miratimit të tyre, që mund të ndodhë sot. Ju faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, i nderuar Qorolli! Tani vazhdojmë me replikë. Gruda, replikë!

PËRPARIM GRUDA: Vetëm ta sqarojmë se nuk duhet lënë në huti publikun, se zoti Qorolli dha informacione që s’ekzistojnë. Nuk është e vërtetë. Amendamenti numër 27 i Shteteve të Bashkuara të Amerikës nuk është iniciuar para 200 vjetëve, e miratuar prapa. Aty thuhet tek “Letrat e federalistit” si kujtime të autorëve të kushtetutës, dhe aty po ashtu thuhet që, gjenerata jonë, thonë ata, që e miraton këtë kushtetutë nuk mund t’ia përcaktojë rregullat gjeneratës tjetër.

Pra, flet për këto që po themi ne, që nuk mund një gjenerate para 15 vjetëve t’i caktojë rregullat e sotme.

Kështu që, ajo e para nuk është e vërtetë. Referenca në Kushtetutën e Shteteve të Bashkuara është plotësisht e pavërtetë. Nuk qëndron.

E vërteta e thjeshtë e kësaj pune është që këtu kemi një afat kushtetues në Rregullore, që thotë dy javë. Dy javë, zotëri! Ne nuk jemi në antikitet me rregulla të pashkruara, jemi me rregulla të shkruara. Lexoje Rregulloren thotë, dy javë. Unë po e pyes kryetaren prapë. Më trego pse i ke sjellë amendamentet 14 vjet mbrapa, kur Rregullorja thotë dy javë?

Jemi në çështje konkrete, nuk kemi nevojë të kthehemi tek teoritë. Që doni kthehemi, por s’na shërbejnë kurrëgjë, përderisa e kemi të kodifikuar me rregullat në Rregulloren e punës.

Edhe një herë kryetare, shpjegona pak pse e ke thirrur seancën pas 14 vjetëve, kur thotë - pas dy javësh?

KRYETARJA: Seanca është thirrur nga 41 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Amendamentet janë proceduar nga Presidentja e vendit. Besoj që je i kënaqur me përgjigjen. Dikush tjetër? A është paraqitur për fjalë? Zonja Musliu?

GANIMETE MUSLIU: Mirëmbërëma të gjithëve!

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

E nderuara kryetare e Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Media,

Dhe të gjithë të pranishmit që jeni në sallë,

Kisha pasur qejf një përgjigje prej Albin Kurtit që të na tregojë prej kujt po tuten që po mbajnë seanca natën. Do të ishte shumë me rëndësi, se po më duket që po tuten fort sa i përket seancës.

E nderuara kryetare,

Edhe në këtë moment kur po flas, unë ende s'kam pranuar ftesë për pjesëmarrjen në këtë seancë dhe jam e bindur që askush prej krejt deputetëve nuk ka pranuar ftesë për thirrje të kësaj seance.

Na ka ardhur një mesazh: "Ejani se kemi seancë në orën 20:00". Mesazhi ka ardhur në 19:47 minuta. 13 minuta para orës 20:00. Ne jemi sot këtu, po sot askush nuk kemi marrë ftesë me shkrim qysh e përcakton protokollin e Kuvendit.

Do të thoni ndoshta dikush këtu, që është seancë e jashtëzakonshme, se u bë nami, edhe pse kurrë nuk është e jashtëzakonshme. Çdo gjë është e zakonshme. Kurrë s'është duke ndodhur në Kosovë. Krejt çka është duke ndodhur në Kosovë është që për dy javë rresht i kemi parë përpjekjet e Albin Kurtit që në Kosovë ta instalojë një sistem totalitar.

KRYETARJA: Deputete, ta tërheq vërejtjen për përdorimin e kësaj gjuhe dhe të lutem përmbaju rendit të ditës!

GANIMETE MUSLIU: Unë të falënderoj shumë për tërheqjen e vërejtjes, veç më trego ku gabova?

KRYETARJA: Besoj e di shumë më mirë se unë.

GANIMETE MUSLIU: Më trego ku gabova?! Cila fjalë e imja ishte fjalë joparlamentare dhe unë kërkohet falje, të lutem!

Sa i përket çështjes së jashtëzakonshme, dua ta kthej edhe një herë në kujtesën e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Kur në Skenderaj vërshimet e rrezikonin jetën e qytetarëve, kur nuk funksiononte asgjë në Skenderaj, kjo Qeveri, këta njerëzi hezitonin. Të lutem, se është krahasim...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Regjia, ia ndërpritni fjalën deputetes! Nuk ka deputetë të tjerë të paraqitur për fjalë, prandaj vazhdojmë me rendin e ditës. Më lejoni që t'ju njoftoj me këshillën juridike: Çdo ndryshim do të kërkojë miratimin e 2/3 të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë 2/3 e të gjithë deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës.

Pra, kjo parashihet në nenin 144, paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Pra, nevojiten së paku 80 vota për, përfshirë këtu 14 vota të deputetëve të komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

Para se të kalojmë në procedurën e votimit, duhet ta konfirmojmë praninë e deputetëve në seancë. Prandaj, fillimisht po votojmë për prezencë. Votojmë tash!

Po presim vetëm pak momente derisa Administrata të na njoftojë.

Atëherë, konstatoj se në seancë janë të pranishëm 93 deputetë, përfshirë këtu edhe 9 deputetë nga komunitetet e tjera, që nënkupton që nuk janë plotësuar kushtet për vazhdimin me votim të amendamenteve kushtetuese.

Ne po e ndërpresim seancën këtu, do të njoftoheni kur të plotësohen kushtet, e sipas informacioneve që i kam do ta kemi edhe një seancë tjetër sonte.

Prandaj, ju ftoj që të qëndroni në ambientet e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në orën 22:00 qenka thirrur seanca e ardhshme, prandaj ju ftoj që të jeni në seancë. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*